



| | | | |
|---|------------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Prania - Dorezuar Punim - Prerab: Received/ Delivered | 18.10.2023 | 3 | viti god year |
| Organ/ Njësia Organ/ Jednica Org. Unit | Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKRIMSHKEX | 6598/2023 | | 1/6 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1101/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1101/2023 të datës 21.08.2023 të ankuesit Prishtina, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.10.2023, mori këtë.

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me A.nr.1101/2023 të datës 21.08.2023 e parashtruara nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi i Komisionit të Vlerësimit i datës 02.08.2023 dhe Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 03.08.2023, ndërsa Anulohet në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 24.03.2023 me numër të Referencës: RN00011280 për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile" në Komunën e Prishtinës.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi, i cili sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit "Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile" të shpallur nga Komuna e Prishtinës, me datë 21.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5750/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1101/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 02.08.2023 me pretendimet ankimore se gjatë vlerësimit të jetëshkrimit nga Komisioni për Ngritje (Avancim) në Detyrë nuk është vlerësuar mjaftueshëm duke marrë parasysh përvojën e punës dhe se kandidati i suksesshëm nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me konkurs.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar me datë 24.08.2023 kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë 31.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 02.10.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2023 dhe numër protokolli:6307/2023, përmes së cilit ankesës së ankuesit A.nr.1101/2023 të datës 21.08.2023 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.08.2023 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 19.07.2023; Vendimi i Komisionit për Ngritje në detyrë i datës 02.08.2023; Njoftimi i datës 14.07.2023; Njoftimi i datës 03.08.2023; Rezultatet e vlerësimit; Procesverbal i datës 18.08.2023; E-mail i dërguar nga A.J drejtuar N.K e datës 31.07.2023; E-mail i dërguar nga N.K drejtuar J.A e datës 28.07.2023; E-mail i dërguar nga M.LL drejtuar A.K e datës 17.08.2023; Vërtetim me numër 665/2023 i datës 13.06.2023; Certifikatë mbi dënimet penale për N.K e datës 16.03.2023; Vërtetim e lëshuar nga Policia e Kosovës e datës 16.03.2023; Akt emërim me numër prot. 1023/2022 i datës 14.11.2022; Akt emërim me numër 418 i datës 30.01.2012; Pasqyrë e llogarisë për N.K; Diplomë e lëshuar nga Kolegji AAB me numër 125319 e datës 18.07.2019; Diplomë e lëshuar nga Kolegji AAB me numër 1425/17 e datës 02.10.2017; Formularë për vlerësimin e rezultateve në punë për N.K e datës 31.12.2022; Letër reference e datës 21.10.2021; Certifikatë e lëshuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë e datës 23.02.2023; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve e datës 23.03.2023; Certifikatë e lëshuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale; Certifikatë e lëshuar nga OSCE e datës 17.08.2011; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 17.10.2013; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia për Regjistrim Civil me numër 01/16 e datës 11.02.2016; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 12.10.2015; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 09.11.2018; Mirënjohje e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike e datës 23.06.2016; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 04.07.2007; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 20.07.2012; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 02.05.2006; Certifikatë e lëshuar nga ATRC e datës 24.04.2009; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Trajnime e datës 04.04.2019; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 29.11.2015; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit e datës 20.12.2012; Certifikatë e lëshuar nga Këshilli Rinor i Rahovecit i datës 09.06.2021; Certifikatë e lëshuar nga Këshilli Rinor i Rahovecit i datës 01.06.2022; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve datës 23.03.2023; Diplomë e lëshuar nga The Cambridge School e datës 03.07.2002; Certifikatë e lëshuar nga

English Language Teaching e datës 01.05.2007; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 20.08.2023; Përgjigja në ankesë e datës 31.08.2023; Vendimi i Komisionit Vlerësues i datës 02.08.2023; Njoftimi i datës 20.04.2023; Formularët e Vlerësimit në intervistë për SH.K (1 deri 4 faqe); Formularët e Vlerësimit në intervistë për N.K (1 deri 4 faqe);Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 03.08.2023; Lista e aplikantëve për test me shkrim; Lista e aplikantëve për Intervistë; Vendim i datës 31.05.2023; Konkursi i datës 24.03.2023; Aplikacioni i N.K i datës 14.04.2023; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 18.11.2021; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 29.10.2015; Aktvendim i lëshuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit me numër 03 Nr.3938 i datës 13.05.2010; Akt emërim me numër 01Nr.418 i datës 30.01.2012; Vendim i lëshuar nga Komuna e Rahovecit me numër 01Nr.3406/158 i datës 30.09.2015; Aktemërim i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit me nr.prot.1083/2022 i datës 14.11.2022; Referencë e datës 03.01.2006; Referencë e datës 03.01.2006; Kopja e letërnjoftimit për N.K; Formularë për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për N.K e datës 31.01.2023; Formularë për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për N.K e datës 28.01.2022; Vërtetim me numër 275/2023 i datës 15.03.2023; Mbështjellësi i lëndës; E-mail i dërguar nga F.A drejtuar KPMSHCK i datës 26.09.2023; Aplikacioni i SH.K i datës 13.04.2023;Certifikatë mbi dënimet penale për SH.K i datës 13.04.2023; Diplomë e lëshuar nga Kolegji Dardania për SH.K me numër 57/21 i datës 07.08.2021; Kopja e letërnjoftimit të SH.K; Vendim me numër 14-112/02-55565/23 i datës 14.03.2023;Vendim me numër 14-020/01-123763/22 i datës 01.06.2022;Vendim me numër 14-020/01-55193/22 i datës 11.03.2022; Vërtetim me numër 012 i datës 08.02.2023; Formularë për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për SH.K i datës 02.03.2022; Formularë për vlerësimin e rezultateve në punë 24.01.2023; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit e datës 20.12.2012; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 03.11.2015; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 20.03.2018; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 04.11.2022; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 18.11.2022; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil me numër 19/19 e datës 11.02.2016; Kontratë për punë me numër 01Nr112-578/3 e datës 10.06.2009; Akt emërim me numër 01-112-578 i datës 30.01.2013; Akt emërim me numër 01nr.112-578 i datës 01.02.2017; Vendimin me shifër VK/2023 të datës 02.10.2023 me nr.prot:6307/2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesi' _____ i, është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Prishtinës me datë 24.03.2023 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit për ngritje (*avancim*) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile" me numër të Referencës RN00011280, ndërsa në bazë të renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 03.08.2023 konstatohet fakti se ankuesi ka marr pjesë në këtë procedurë dhe ka arritur t'i mbledh gjithsej 67.07 pikë, duke u renditur si kandidat i dytë në listë, mirëpo nuk është përzgjedhur si kandidatë fitues.

Ankuesi, i pakënaqur me renditjen përfundimtare të kandidatëve, kishte parashtruar ankesë të brendshme me pretendimin ankimor se Komisioni i Vlerësimit me rastin e vlerësimit të jetëshkrimit

dhe përvojës së punës së kandidatit të përzgjedhur kishte vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa Komisioni Vlerësues përmes Vendimit të datës 02.08.2023 kishte refuzuar ankesën e ankuesit me arsyetimin se Komisioni Vlerësues ka vlerësuar jetëshkrimin e kandidatit në përputhje me rregulloren dhe përgjigjeve të dhëna në intervistë dhe si rrjedhojë Komuna e Prishtinës ka nxjerr Njoftimin e datës 03.10.2023 për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën e shpallur të konkursit nga rezultoni se ankuesi nuk ishte kandidat i përzgjedhur.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstaton së në konkursin e datës 24.03.2023 të shpallur nga Komuna e Prishtinës, për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile", me numër të Referencës RN00011280, kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Psikologji, Sociologji, Juridik.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Se paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me kërkesën e tij për anulimin e konkursit për shkak se kandidati fitues nuk e ka përmbushur kriterin e konkursit lidhur me përvojën e punës profesionale, Kolegji i Këshillit pas analizimit të aplikacionit dhe dokumentacioneve të bashkangjitura të dorëzuar nga kandidatja fituese SH.K, ka konstatuar se kandidatja fituese posedon Diplomën e datës 07.08.2021 me numër:57/21 përmes të cilët dëshmohet fakti se e njëjta ka mbaruar studimet themelore me datë 31.07.2021 duke diplomuar në Programin Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale në Kolegjin Dardania, ndërsa Komisioni Vlerësues me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit duke e përfshirë edhe kandidaten e përzgjedhur për të vazhduar në fazat e mëtejshme të vlerësimit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: "3. Përvoja profesionale dhe/apo menaxheriale llogaritet pas diplomimit në ciklin e parë të studimeve themelore", ngase kandidatja e përzgjedhur deri me datën 13.04.2023 kur ka aplikuar në konkursin në fjalë e njëjta ka pasur më pak se dy (2) vite përvojë pune profesionale/ pas diplomimit në fushën për të cilën është kualifikuar sikurse përcaktohet edhe me nenin 18 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, nga rrjedh se e njëjta nuk ka arritur të përmbush kriterin e përvojës së punës profesionale prej tri vitesh siç edhe përcaktohet edhe me konkursin e datës 24.03.2023, prandaj secili veprim i ndërmarrë procedural pas kësaj faze nga Komisioni Vlerësues duke përfshirë përpilimin e listës së ngushtë, rezultatet e testit me shkrim dhe intervistës me gojë e deri te Njoftimi i Komisionit Përzgjedhës për kandidaten e suksesshme janë të pavlefshme juridikisht dhe nuk mund të prodhojnë efekte juridike pasi që deri të ky rezultat ka ardhë si pasojë e një procedure të përcjellë me shkelje të dispozitave të ligjit material dhe LPPA-së.

Po ashtu, Njësia Përgjegjëse me rastin e përfshirjes së kandidatës së përzgjedhur në listën e ngushtë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullore (QRK) nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, specifikuat dispozitat e nenit 15 paragrafi 3 dhe 5 ku thuhet se: "3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi

për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve”, andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Njësia përgjegjëse e Komunës së Prishtinës për Konkursin me numër të referencës RN00011280, në listën e ngushtë ka përfshirë edhe kandidaten e cila nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme formale të konkursit dhe pa të drejtë kanë vazhduar në fazën e mëtejshëm të konkurrimit duke arritur që të përzgjidhet si kandidatë fituese e konkursit në fjalë, rrjedhimisht procesi i rekrutimit nuk ka qenë i drejtë dhe nuk ka garantuar mundësi të barabarta për përzgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse.

Bazuar si më lartë, nga shkresat e administruara të lëndës si dhe gjetjeve të shkeljeve të rregullave dhe parimeve të pranimit në shërbimin civil lidhur me vlerësimin e aplikacioneve të kandidatëve, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik ku përcaktohet se: “1. Pranimi në detyrë i nëpunësit Civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive”, pasi që me rastin e vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve në listën e ngushtë ka përzgjedhur kandidatë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale të konkursit, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit njëzëri ka vendosur që procedura e kontestuar përmes kësaj ankese të anulohet në tersi, gjegjësisht Njoftimi i kandidatit fitues të datës 03.08.2023 është shfuqizuar, ndërsa Konkursi i shpallur me datë 24.03.2023, për pozitën “Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile” me numër të Referencës RN00011280 është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi Komuna e Prishtinës nuk ka përfillur kriteret e pacaktuara me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërlidhur me shtojcën Nr.1/5 për klasën Drejtues i Ulët, nga rrjedh se kërkesa e ankuesit për anulimin e konkursit është e bazuar në ligj dhe e njëjta është aprovuar.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit meqenëse ka konstatuar se me rastin vlerësimit të përvojës së punës së kandidatit të përzgjedhur të kontestuar me këtë ankesë nuk janë përfillur parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, ka vendosur njëzëri se përbën bazë të mjaftueshme ligjore që konkursi të anulohet në tersi, ndërsa nuk është lëshuar në shqyrtim e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit për vlerësimin e jetëshkrimit të ankuesit, pasi që nuk do të kishte asnjë efekt të ndryshëm juridik.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1101/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.